


BUJAR XHAFERRI

BIBLIOTEKA


SH-1  
Xh 17

*Gjërat  
e përkohshme*



*poezi*

1915/23-1



### BUJAR XHAFERRI

Lindi më 1956 në qytetin e Beratit. Me përfundimin e studimeve të larta (dega gjuhë-letërsi) punon në Lushnje.

Ka botuar deri tani këto vëllime poetike:


«Faleminderit»

«S'mund të rrija pa i thënë të gjitha».

SSH-1  
2417

BUJAR XHAFERRI

**Gjërat  
e përkohshme**



**poezi**

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

*Redaktor*

ISUF NELAJ

*Piktor*

EDVIN RAMA

*Recensues*

Agim Spahiu

Bashkim Kuçuku

Razi Brahimi

## PORTA E PRITJES SË POPULLIT

Kjo portë rri hapur në çdo çast,  
kjo portë ku hyj pa u kërrusur,  
pa lutje prej të vogli,  
pa ceremonial.

Kjo portë që më çlodh kur jam  
i lodhur,  
që më gëzon kur jam i trishtuar, —  
kjo portë s'ka çelës,  
ka vetëm zemër.

Kjo portë rri hapur çdo ditë pa orar,  
si portat e uzinave turn pas turni,  
si portat e urgjencës në spital.

## DEKORIMI I PUNËTORËVE TË FUSHËS

Në mëngjes dhe në mbrëmje, çdo orë dhe  
çast  
punëtorët e fushës me diellin janë pranë,  
kur prashisin bimën, kur i japin ajër  
dielli sipër tyre rri si dëshmitar.  
Largësinë astronomike të diellit me tokën  
punëtorët e fushës e besojnë fare pak..  
dhe vonë në muzg, në skaj të fushës,  
prej diellit mbetet një njollë e kuqe  
si dekoratë për çdonjërën prej tyre.

# MBRETËRIMI I FËMIJËS NË KARROCËN E DORËS

Mbi kokë i kanë vënë një kapele të bardhë  
akademiku,  
fodullit të vogël, arrogantit joshës,  
me atë fytyrë çuditërisht serioze  
dhe të bardhë, të bardhë si dëbora.  
Si padishah i përrallave arabe,  
si perandor i Bizantit të lashtë  
ai ecën rëndë, rëndë

nëpër qytet,  
hipur në karrocën e tij me tendë,  
ulur këmbëkryq në salltanetin e bardhë,  
që e shtyjnë, e tërheqin, e  
tundin, e kolovisin,  
dy prindërit e tij buzagaz,  
të vetmit «skllevër» të lumturi në botë.  
Lumturohem dhe unë bashkë me ta në çast,  
kërrusem i tëri si rojë besnike,  
në çastin kur po shkon plot hire imzot, —  
i bindur se të gjithë mbretërit kanë dështuar  
pikërisht se mbretërimi veç të vegjëlve  
u shkon.

## F U S H Æ

Në fushën e pafund me hapësirë pa skaj,  
jetoj krejt i qetë pa brenga karrieristësh,  
përmasat e mia këtu janë reale,  
në fushën e artë,

pa delire, pa jerm,  
pa piedestalet e trukuara me shkëlqim të  
rremë

të miteve megjiplota të lashta dhe moderne.  
Gjithçka është rrafsh — syri shikon larg,  
mendjemadhësia e çdonjërit dekonspirohet  
menjëherë —

këtu ku s'ka as xhuxhë, as gjigantë,  
ku askush s'i shikon të tjerët nga lart  
me sy të vrazhdë prej të madhi.

Gruri diçka me pëshpërit në çdo stinë  
dhe unë di ta kuptoj zhargonin e tij.

Dielli në muzg si një filozof i urtë,  
poshtë në fushë zbret pak prej reve  
dhe rri ca çaste i barabartë mes njerëzve.



## E QESHURA E PAPRITUR E NJË VAJZE NË RRUGË

Të vetmuarit në rrugë ecin seriozë,  
ndonjëherë të ngrysur, të rëndë,  
të vrazhdë;  
ky është një zakon i vjetër i njerëzve,  
jo se të qeshurit është një mëkat.

Krejt ndryshe nga ky standart i lashtë,  
ti ecje e vetme dhe qeshje çuditërisht.  
Pa dorën te goja e vure një çast  
të mos keqkuptonin kalimtarët përbri.

Të mos thoshin ndoshta «ah, qenka e marrë»  
ti gojën e bukur e mbulove me flokë,  
por e qeshura te sytë u shfaq sakaq,  
pa e përfillur këtë postbllok.

Pa e përfillur autocensurën,  
shndriti në tërë qenien tënde më fort:  
(me zor, e turpshme,)

si dashuria;  
si çdo gjë e hirshme që shfaqet në botë.

## NË KËTË MËNGJES DIMRI

Në këtë mëngjes të ftohtë dimri,  
nxënësve të mi në fshatin më në

skaj;  
po u flas për Migjenin e madh shëndetlig,  
për Lulin e vocërr dhe për Zenelin...  
Dhe befas në çast më kapi trishtimi,  
kur pashë se në klasë s'kish më harrakat',  
ngacmime tinëz, pëshpëritje nuk kish —  
dhe kishte vetëm sy të mëdhenj,  
të bukur, të trishtë,  
Po sikur njeri prej tyre, —

thashë me vete, —  
të kish këpucë të grisura,  
të ishte pa xhaketë,  
ata s'do trishtoeshin njëloj sigurisht,  
për Lulin e vocërr dhe për Zenelin?!  
...Dhe unë s'do të guxoja vetëm prej tij  
të shpjegoja këtë mëngjes Migjenin.

SIMPATIZANTI I ROMANIT  
«DON KISHOTI I MANÇES»

Ka vite dhe vite që nuk shkruan  
asnjë rresht,  
ka vite që hesht,  
që shokëve s'u tregon për veprat që do të  
shkruajë,  
njeriu që kish vendosur të bënte epokë.  
Tani është plakur dhe flokët i janë bërë  
të bardhë, të bardhë,  
i ka harruar ato vite kur deshte sukses.  
Po shokëve në kafe u tregon me humor  
kapituj nga romani «Don Kishoti i Mançes»,  
dhe çuditërisht përsërit shpesh e më shpesh  
se këtë roman Servantesi e shkroi 60-të vjeç!

## KUR MUNGOJ DITË TË TËRA

Nuk dua të më qortosh kur mungoj  
ditë të tëra,  
kur ndodhem larg teje mos u trishto ti.  
Unë e di, dashuri do të thotë të jesh  
afër,  
kështu thotë dhe proverbi,  
dhe libri juridik.  
Por unë e kam kuptuar se dashuri do të  
thotë

të jesh edhe larg  
dhe përsëri e dashura të mos mungojë  
për asnjë çast.  
Pra, mos më qorto ku vij nga larg,  
kur kam munguar për ditë e ditë të tëra,  
mos u bëj e plogët në këtë çast.  
Dhe në vend të paralajmërimit të rreptë,  
të ashpër:

«është hera e fundit që po të fal»,  
më thuaj më mirë përsëri se më do,  
se ndryshe, e dashur, je ti që mungon!

## KARRIGET E SHTËPISË SIME

Karriget e shtëpisë sime,  
të zakonta krejt,  
me pak llak të vjetër,  
ndonjëherë të zbehtë.

Ato s'janë fiksuar rreth tryezës

në qoshe;

karriget e shtëpisë sime transferohen shpesh:  
nga kati i parë

në katin e dytë,

nga një apartament, tek një apartament,  
aty ku ka një dasmë me njerëz të qeshur,  
aty ku ka një vaj me njerëz të zymtë.

Karrige portative,

pa ndonjë estetikë,

që asnjëra prej tyre nuk njeh zot të

përhershëm,

secila prej tyre mund t'i pozonte Van

Gogut,

kur pikturoi Karrigen e Gogenit!

Çdonjëra prej tyre është dhe s'është imja  
dhe unë s'kërkoj prej tyre një bukuri tjetër.

E VETMJA PËRSËRITJE QË S'ËSHTË  
MONOTONE

Gjithmonë kam përsëritur dashurinë për ty;  
çdo vit, çdo stinë, çdo minut', çdo sekondë.  
Ka shkuar kaq kohë dhe ti megjithatë  
ende s'e ke humbur delikatesën e duarve,  
as ngjyrën e gojës,

as kthjelltësinë e syve,  
as hirin e shtatit, as dritën nëpër flokë.  
Çdo ditë kam përsëritur dashurinë për ty,  
refrenin më të lashtë e më njerëzor në botë,  
simfoninë më të gjatë, më të gëzuar e më të  
trishtë,

(të pakufizuar kurrë në kohë muzikore,)  
unike si dielli në sistemin tonë,  
origjinale si ëndrra,  
e pafund si hapësira,  
e pezmatuar si plaga,  
euforike si drita.

Çdo ditë kam përsëritur dashurinë për ty,  
me sigurinë që përsëriten vetë javët dhe  
ditët.

Dhe s'kam besuar në zemra të lehta,  
çamarroke,

që gjurmojnë të hutuara dashuri të reja.  
Çdo ditë kam përsëritur dashurinë për ty,  
të vetmen përsëritje që s'është monotone.



## I PARAKOHSHMI

U dekonspirua dashuria e tij,  
u përfol në klasë vesh më vesh midis  
shokësh,  
në klasat paralele në të gjithë shkollën...  
U bë problem në këshillin pedagogjik,  
në drejtori...  
Unë e shikoj gjimnazistin të trishtë,  
unë që e di mirë pedagogjinë,  
që di ta fsheh me përvojë dashurinë,  
që dashuroj gjithmonë brenda rregullit,  
që di të stepem, di të largohem,  
kur dashuria më sjell pak rrezik.  
E shikoj gjimnazistin, e qortoj,  
mbaj qëndrim,  
se unë që di të fsheh, nuk bëj asnjë lëshim!  
E shikoj me qortim dashuruesin e  
parakohshëm  
që prishi rregullin pedagogjik,  
e shikoj dashurinë e tij të pafshehtë,  
dashurinë që duket lehtë, menjëherë,  
siç duket që larg në mes të qytetit,  
një monument.  
E shikoj adoleshentin të përskuqur,  
të trishtë,

të zbuluar, të pafshehtë,  
shoh modelin e burrit  
që dashurohet vërtet.

## I VOGLI DHE I MADHI

I sheh ata yje të barabartë,  
që ndrijnë krejt njëlloj në largësi?  
Astronomë thonë se njëri prej tyre  
është treqind herë më i madh nga tjetri.



## DY SPEKTAKLE NË BAR «BLERIMI»

Nga tarraca, e bar «Blerimit»  
si nga një lozhë teatri,  
njerëzit shikojnë poshtë në fushë  
një diell të madh që zbret në muzg  
dhe jep një spektakël njerëzor,  
të madh:

balet rrezesh,  
variacione ngjyrash,  
si një artist klasik, endacak.  
Dikush në këtë çast zbret nga vetura dhe  
ecën ngadalë me kokën lart,  
ai pret sakaq ta shikojnë njerëzit sakaq,  
(ai do të ishte i lumtur në këtë çast;)  
por dielli vazhdon spektaklin e tij,  
pa ditur fare për rivalin e pafatë!

## FQINJA IME DIKUR VRAPONTE ME SANDALE

Fqinja ime dikur vraponte me sandale,  
e bukur, e lehtë, e praptë, mendjemadhe...  
E pashë fqinjën time të plogët çuditërisht  
me këpucët e rënda të ceremonisë.

Me takat e larta sikur shkelte mbi brenga,  
e heshtur, e sjellshme, pa trille, pa teka,  
Të kam thënë, vogëlushe, kur vrapoje me  
sandale,

ty, diktatore zemrash djaloshare,  
se dashuria është gjithmonë triumfuese  
mbi kryelartësinë e përkohshme të një vajze.

## HARRESA E FËMIJËVE

Në qoftë se harron të vish të shtunën,  
mos harro siç harrojnë të mëdhenjtë,  
se harresa e të mëdhenjve është ndonjëherë  
truk autoritarë është gjest mirësjelljeje.

Harresë që s'të bën aspak për të qeshur,  
harresë trishtuese, plot seriozitet.

Në qoftë se harron të vish të shtunën,  
mos harro, pra, si të mëdhenjtë,  
se harresa e të mëdhenjve ndoshta ka

arsye,  
një arsye që mua do të më sjellë trishtim,  
dhe mund të jetë e gjatë harresa e të

mëdhenjve,  
e gjatë, e gjatë, gjer në harrim.

Më harro si fëmijët po s'erdhe të shtunën,  
si fëmijët kur harrohen pas balonave të

pranverës,  
atëherë unë do të qesh me harresën tënde  
dhe nuk do të besoj aspak te harrimi.

## RIKTHIM NË NJË MOSHË TË HERSHME

Në çastet e dashurisë me ty  
jam bërë krejt fëmijë  
dhe e kam humbur arsyen e të madhit.  
Kam harruar sa bëjnë njëqind herë njëqind,  
kam harruar llogaritë që bëjnë të mëdhenjtë...:  
sepse ti si një Mede e lashtë  
më ke bërë krejt fëmijë,  
20 vjet më të ri.  
Dhe më ke kthyer pikërisht në atë  
moshë  
kur njeriu beson në dashurinë.

TI QË NGURRON TË HYSH  
NË SHTËPINË E FSHATARI

Ty të fton fshatari, të lutet,  
të kap për krahu sinqerisht,  
ti hesht, ngurron,

kthehesh mbrapsht,  
ti dyshon për «kompromis» — ç'logjik' e  
hollë!

Fshatari është aq i mirë, sa këtë s'e kupton,  
ai prap' të lutet, të hedh krahun miqësisht,  
fshatari që s'e lëvdon shtëpinë e tij.  
fshatari që ti s'e fton asnjëherë  
në shtëpinë tënde në qytet.

Në shtëpinë që gruaja, jote e lëvdon,  
që edhe ti qëllon ta lëvdosh ndonjëherë.  
Fshatari që gëzohet lehtë,  
që mërzhitet rrallë për gjëra të mëdha,  
kur ti gëzohesh rrallë, dhe ngrysesht  
menjëherë

nëse nuk janë ngrohur kaloriferët e zyrës  
në orën shtatë në mëngjes...

Fshatari që harron se ti je zyrtar  
në çastin që të tërheq për krahu si mik,  
fshatari që ti e lëvdon nëpër mbledhje,  
fshatari që ti e qorton e kritikon,



fshatari që bën seriozisht autokritik',  
i bindur se ti i di gjërat më mirë.  
Fshatari që s'i shkon kurrë në mendje,  
se ti, po të hysh në shtëpinë e tij,  
rrezikon të «prishësh» figurën tënde.

## E D I E L

Nesër është e diel  
dhe fëmijët janë të gëzuar që s'do të  
shkojnë në shkollë,  
që s'do të ecin sipas «urdhrit» shkollor në  
rresht,  
që do të mbushin qiellin e tyre me balona,  
se nesër është e diel.  
Dhe unë e lavdoj gëzimin e tyre,  
gëzimin fëmijëror të drejtë,  
të vërtetë.

Nesër është e diel,  
ç'ditë e mrekullueshme do të jetë nesër  
për mua që do të çlodhem,  
për mua që do të eci në mëngjesin me diell,  
në rrugë krejt i qetë.  
Po ti që nuk lodhesh asnjë ditë të javës,  
çdo të bësh ti nesër,  
se nesër është e diel.  
Ç'ditë e mërzitshme do të jetë për ty nesër,  
do të ndeshesh me diellin  
dhe do të shiheni vrëngët,  
si dy armiq të vjetër me njëri-tjetrin!

## JASHTË TEME

Djaloshi u bashkua i pafaj me vajzën,  
siç ndodh me të njohurit në rrugë rastësisht,  
dhe nxitoi t'i fliste për gjëra të largëta,  
për gjëra që s'i ngjanin aspak dashurisë.  
I tregoi për gjyshen e tij shakatore,  
për një shok që mbante nofkën çukapik,  
për dështimin e tij tragjiko-komik  
në krosin dimëror të atyre ditëve...  
Por ndërkaq një piktor i fshehtë, i  
mistershëm,  
me një penel të padukshëm drite dhe  
brenge,  
vizatoi në fytyrën e tij ca njolla,  
gri, të bardha, blu, tronditëse,  
pak rozë të trishtë, pak të kuqe të  
shndritshme...  
Si një mësues i rreptë që shënon shumë  
vërejtje  
mbi hartimin e një nxënësi të dalë keq  
jashtë teme.

## PRELUDI I VAJZËS SË RRITUR

Pa çantën e librave, pa përparësen e shkollës,  
ajo doli në qytet për herë të parë;  
ishte një shëtitje krejt e papritur  
apo mbase dita që ish kaq e bukur  
kish zgjuar trillet e mistershme të saj?  
Dhe befas ndeshi shikimin e një djali —  
u hutua për një mend, uli sytë në tokë,  
si gjimnastet diletante mbi traun e  
ekuilibrit,  
kur ecin lehtë, të pasigurta e me zor.  
Pastaj ngriti kokën dhe shpejtoi hapin,  
nga kreu tjetër i bulevardit.  
Po më tej dikush tjetër pa zor buzëqeshi  
dhe njërrën vetull e ngriti lart.  
Ç'po ndodhte? Vajzës iu morën mendtë, —  
ç'ishte kjo ditë kaq e praptë?  
U kthye dhe s'kuptoi se kjo shëtitje  
ishte premiera me brengë e saj.

## KLOUNËT

Ju kam dashur kaq shumë në fëmijëri,  
tani që jam burrë, më trishtoni shumë,  
me ato pantallonat tuaja të gjera,

me grimin e çuditshëm, me sytë e bufatur,  
me hundën e përlyer, të pahijshme për një  
burrë.

Më trishtojnë klithmat dhe grimasat tuaja  
dhe besimi fëmijënor se do të jeni të  
famshëm.

Fëmijët përsëri qeshin me ju,  
ju duartrokasin, ju dashurojnë,  
ju çmojnë si njerëzit më të mençur në  
botë;

fëmijët që nesër do të jenë burra  
dhe në mençurinë tuaj ndofta do dyshojnë.

Ju shikoj përsëri në arenën e gëzimit  
fëmijëror,

klounë të magjishëm, ju shikoj si dikur,  
si fëmijë i hutuar mes zërave gazmorë,  
nuk e bëj mëkatin t'ju shikoj si burra.

## ALARM I FËMIJËVE NË PARK

Në parkun e skajshëm të qytetit,  
ku shpesh nuk kish kalimtarë,  
kuptohet, pa drojtje ata ecnin,  
të qeshur të kapur krah për krah.

Fëmijët loznin aty,  
heshtnin me shikimet e buta,  
vetëm ndonjëri klithte mbytur:  
— O çuna, shikoni, po e puth!

Po kjo për ata s'prishte punë,  
vërtet ç'punë mund të prishte,  
në atë muzg aq të lumtur,  
habia e vërtetë e një fëmije?

Për ditë të tëra munguan  
në parkun e skajshëm ata.  
Fëmijët nga kjo s'u trishtuan,  
fëmijët njëlloj luanin prapë.

Por një mbrëmje papritur ata shtangën  
në parkun e skajshëm të tyre.  
Ishte ai djalë por ish tjetër  
ajo që i qeshte te supet.

Fëmijët lanë lojën në çast,  
fëmijët e zhurmshëm, të mirë  
dhe sytë e tyre të butë  
u bënë të mëdhenj, të trishtë.

## SI KRIJOHËT NJË GJËZË

Nëse unë do t'ju thosha  
se dje në muzg udhëtova  
bregut me pisha të detit me një njeri  
që më foli për shpendët,  
për bajzat, shkurtën, rosën e egër...  
që më thosh se turtulli vjen në prill  
dhe bashkë me gargullin ikën në tetor,  
se shkurta rri strukur nëpër shkurre,  
ku e përgjojnë me ankth zagarët...  
— O, — do të thoshit ju, — ky miku yt  
i mbrëmshëm,  
ky shoku yt i udhës, paska qenë një  
gjahtar!



## SOT U ZGJOVA NË MËNGJES PAPRITUR

Sot u zgjova në mëngjes papritur,  
pa rënë ende sinjali i orës,  
sipas komandës në kohën fikse.

Ah, — thashë, — paska ardhura pranvera, —  
se zogjtë te dritarja grindeshin e

me një gjuhë të ngatërruar cicërimash!  
Po si, kaq shpejt erdhi kjo pranverë,

dhe me huret e saj, me magjinë e cicërimave  
ma prishi krejt rregullin e ditës?  
Kaq shpejt, kaq shpejt, erdhi kjo

kundër sinjalit të orës së kurdisur,  
kundër rregullit të ca njerëzve hijerëndë,

që shallin prej stofi dhe pallton e madhe  
i heqin në një ditë fikse të majit,  
që përsërisin ca fraza të vjetra latine

për marsin mashtrues  
dhe për prillin me trille?!  
Ata shkelin syrin, djallëzisht buzëqeshin,

s'u besojnë cicërimave,  
kaltërsisë së qiellit...

Por unë sot do të dal levend,  
me këmishën e hollë,

me xhaketën e lehtë.

Dhe bujqit kështu do të kenë dalë  
nëpër fushat, pafund, nëpër grurin e gjelbër.  
patjetër,

Dhe fëmijët që e besojnë të parët pranverën,  
sigurisht do t'i kenë flakur xhakaventat  
kundër merakut shekullor të gjysheve.  
Se pranvera erdhi, erdhi vërtet;  
ja zogjtë te dritarja cicërijnë,

sikur tallen me të gjitha proverbat latine  
për marsin mashtrues dhe prillin kapriçoz,  
sikur duan që një tjetër proverb  
për ardhjen e pranverës njerëzve t'u  
lodrojnë,  
mësojnë.

## ESKIZ PËR FËMIJË DHE PËR BURRA

Mbështes duart miqësisht në një bankë të  
klasës  
dhe bëj një pyetje as të thjeshtë, as të  
vështirë;

pas pak çohen lart ca duar delikate:  
— Ta them unë, mësues, ta them unë?  
Por unë shtang në çast se duart i ngrenë  
edhe ata që s'e dinë mësimin, —  
ah, ngrenë duart e rreme të prestigjit,  
duar të zbehta që dridhen në ajër,  
si gjymtyrë falso të teatrit të kukullave,  
që i lëvizin aktorët e fshehur pas kuintave.  
Unë nuk e demaskoj trukun e tyre,  
tërhiqem në çast se më vjen keq  
për ato duar që dridhen, që ngrijnë në ajër,  
që plogështohen si të ishin proteza.  
Veç i them vetes një çast me zemërim:  
Ç'ndodh kur falim ca duar burrash  
që ngrihen të rreme vetëm për prestigj?!

## BESOJ VETËM NJË DASHURI

Besoj vetëm një dashuri,  
një dashuri të shenjtë, të përsosur  
që nuk guxon të përsëritet dy herë.  
Dashuria si njeriu lind vetëm një herë;  
jo dy, jo tre...  
dhe e di se këtë ndonjëherë e besojnë  
fare pak njerëz.  
Dhe e di se kjo ndodh se dashurinë e imitojnë  
të gjithë:  
të gjitha urrejtjet, të gjitha tradhëtitë,  
hakmarrjet, zemërimet, dinakëritë,  
kompromiset e meritë.  
Të gjithë falsifikojnë pasaportat e tyre  
për të kaluar në postëbllokun e saj,  
që s'është i rreptë fatkeqësisht aspak,  
që është zemërgjërë, delikat, i brishtë. —  
Por unë besoj vetëm një dashuri  
dhe sikur të ndodhë që shumë t'i kem  
kundër.

## GJËRAT E PËRKOHSHME

Gjerat e përkohshme krijojnë të përjetshmen:  
Zëniet e pajtimet e shpeshta midis nesh,  
betimet, meritë, mosmirënjohjet,  
euforia e një mbrëmjeje dhe dëshpërimi i  
një mëngjesi. . .

Mos u tremb prej tyre, mos u tërhiq!  
Gjerat e përkohshme krijojnë dashurinë;  
pendimet e shpeshta dhe gëzimet e befta,  
dilemat e lodhshme dhe dyshimet që brejnë.  
Mos u tremb prej tyre, mos u tërhiq!  
Gjerat e përkohshme zbehen, vjetërsohen,  
konsumohen si shtyllat elektrike në skaje,  
zbardhen si këmishët e shkollarëve në verë,  
ripërtërihen si bari i paasgjësueshëm  
gjithandej:  
se gjërat e përkohshme mbartin të  
përjetshmen.

## FËMIJA I ZEMËRUAR ME BURRAT

Në bisedat e shpeshta  
të këtyre burrave  
lavdërohen shpesh bëmat e një fëmije  
dhe emri i tij kujtohet prej tyre  
si një emër i respektuar nëpunësi zyre.  
Ata zgjasin krehët, e ndjekin,

e kapin,  
por ai u ikën, u shpëton nga duart,  
nxjerr gjuhën i përqesh, i quan

«mamuthë»

dhe ikën e ikën me vrap.

Se s'i pëlqen aspak shoqëria me këta burra,  
s'i pëlqen aspak që ia dinë edhe emrin,  
këta burra që e thërresin babanë e tij  
me «shoku»,

që krejt pa shkak qeshin e qeshin.

I mërzitur prej tyre ai është bërë nervoz;  
grindet, qan, bërtet, bën zhurmë.

— Ç'bënë kështu, — i ati e qorton, —  
ti nesër, i thotë, do të bëhesh burrë.

Por i biri në këtë çast përplas këmbët  
më keq,

si ta kish prekur babai i urtë,  
dhe thotë me inat, dhe thotë me dënësë:

— Nuk dua të bëhem asgjë, asgjë,  
dhe sidomos nuk dua të bëhem burrë!

## LETRA TË BARDHA MBI TAVOLINË

Shtohen dhe shtohen çdo ditë letrat e bardha  
mbi tavolinën time:  
pirgje të vogla të shpërndara pa rregull mbi  
rrafshin e saj,  
mbi tavllën e duhanit, mbi filxhanin e  
harruar të kafesë...

Dhjetëra fraza të prishura, të lëna përgjysmë,  
të pasigurta  
shfaqen nëpër to të druajtura, bëlbëzuese,  
si goja që dridhet e adoleshentit të  
dashuruar.

Unë befaz hap dritaren dhe njëherësh  
letrat e bardha  
kërcejnë një balet absurd mbi tryezë,  
mbi dysheme.

Qetësia e tyre e shurdhët u prish, ato  
fluturuan në ajër,  
si brenga të dikurshme, si gëzime të befta,  
si ëndërra padrejtësisht të harruara.

Dhe unë u gjenda i rrethuar mes tyre  
si Guliveri prej xhuxhëve në ishullin e  
vetmuar.

Vrapova t'i kap në ajër,  
në fluturim,  
t'i frenoja duke u vënë pesha të rënda,



por pas shpinës sime vallëzonin të tjera.  
Ngriheshin, fluturonin, ngjiteshin, binin,  
frazat e lëna përgjysmë bëheshin më të  
dukshme  
dhe sikur forcoheshin, sikur donin të flisnin.  
Qesha dhe i lashë të lira të fluturonin si të  
marra  
se ishte i vetmi çast kur nuk më trishtonte  
rrëmuja e letrave të bardha.

## KLUBI NË PERIFERI TË QYTETIT

Aty hyjnë e dalin punëtorë shpesh:  
mekanikë, muratorë, shoferë...  
Mbështesin bërrylat e veshur me bluxhins  
mbi banakun prej fibre të thjeshtë.  
Një gotë verë, një teke raki,  
pak djathë të bardhë, një huqher  
një qepë...

E ç'garniturë — kjo s'ka rëndësi —  
punëtorët tregojnë historitë e ditës  
dhe shkrihen së qeshuri.

Unë shoh me pasion fytyrat e tyre,  
të qeshura, të hareshme, plot dritë;  
të pavrara nga asnjë mërzi intelektuale,  
nga asnjë ëndërrim i lodhshëm për pozitë.  
Të pavarura nga dëshira munduese për famë,  
nga makthi i pritjes së duartrokitjeve...  
Të lirë nga këto brenga ata qeshin, qeshin  
dhe i tregojnë njëri-tjetrit historitë e ditës.

## APOLOGJIA E MANEKINËVE PREJ DRURI

Kisha vite që s'i kisha parë manekinët prej  
druri,  
ato profile të hequra me shikime ëngjëllore,  
po ja ku u shfaqën përsëri prapa xhamave  
si modele që s'i plak dot asnjë kohë.  
Sa mallkime kam hedhur unë vetë mbi ta:  
«manekin servil, manekin lodër,  
manekin mashtrues, manekin perfide, ...»  
Po ja ku u shfaqën përsëri ata,  
të ngrirë në skaje përballë njëri-tjetrit,  
të pikëlluar, delikatë, me shikime të  
pafajshme,  
imitime të sinqerta të konstrukteve

njerëzore.  
E sheh, më thanë mua, se s'jemi gjë tjetër  
veç torsi yt statik, i saktë gjeometrikisht,  
kurse ti je tallur me emrin tonë,  
e ke përdorur si epitete për të këqijtë.  
Unë eci pranë tyre, i prek, i vështroj;  
figura të pikëlluara,

të poshtëruara prej meje —  
dhe për herë të parë ndoshta besoj  
në apologjinë e tyre memece.

## BESNIKËRI BASHKËSHORTORE

Kushedi sa herë kanë provuar zoologët  
besnikërinë bashkëshortore të zogjve  
shtegtarë;  
kanë përgjuar me vite dashurinë e tyre,  
rënkimet nëpër degë dhe trillet në ajër.  
Pastaj kanë dyshuar në dashurinë e tyre  
dhe prapë i kanë ndjekur në gjithfarë  
kurthesh,  
kanë hetuar foletë e tyre të dikurshme  
dhe janë gëzuar kur i kanë kapur  
«flagrant»  
po ata çifte pëllumbash, a çifte lejlekësh  
që bënin dashuri dhe një vit më parë!  
— Krejt si te njerëzit, kanë thirrur të  
gëzuar  
përgjuesit e dashurive të zogjve shtegtarë,  
veçse ende s'kanë zbuluar zoologët  
divorce të shpendëve të dashuruar!

## ZGJEDHJA E PERSONAZHEVE TË FABULËS

Fabulisti menjëherë e la mënjanë ujkun,  
si kandidat personazh të fabulave të tij,  
se ujku është rralluar mjaft në pyjet tona,  
se ujku s'është tipik.

Çakalli mungon në faunën tonë,  
dhelpra gjithashtu është bërë mjaft e rrallë,  
dinakëritë me kohë kanë emigruar,  
larg pyjeve tona, sa më larg!

Ja gjeli mendjemadh, kaprolli mendjelehtë,  
mëzi arrakat. . .

Këta do të jenë personazhet e mi,  
edhe këta mbartin fenomene  
që duhen demaskuar se sjellin rrezik.

## MOS U ÇUDIT

Sot do të trokas në portën tënde,  
mos u çudit, mos më quaj të marrë,  
jam kaq i kthjellët, i thjeshtë,  
i vërtetë,  
jam krejt i pafaj.  
Mos u zemëro,  
se zemërimin do ta quaj menjëherë maskë,  
mos u çudit,  
se çudinë do ta kesh me siguri falas.  
Sot jam i vërtetë, jam i sigurt  
dhe pa zor do të vijë në portë të trokas.

## NJË MËSIM NGA LËNDA E MJESHTERISË SË AKTORIT

Fëmijën befas e pyet dikush:

— Cilin do më shumë, cilin, xhan, —  
nënë apo babanë?

Fëmija qesh një çast,  
siç qeshin shpesh fëmijët kur dyshojnë  
për ndonjë «hile» miqësore që u bëjnë të  
mëdhenjtë, —  
fëmija lëkundet, hutohet, nuk beson se e  
pyesin vërtet.

Fëmija shikon babanë që qesh,  
fëmija mendon, mendon:

(Babai qesh po përse qesh?)

Fëmija për herë të parë mendon kaq gjatë,  
se fëmija zakonisht përgjigjet me zemër,  
përgjigjet në çast.

— Babanë, babanë! Pas pak fëmija thërret;  
babanë thotë arsyeja,  
se zemra flet ndryshe,  
zemra budallaqe që s'di të

gënjejë.

Fëmija e ngre zërin më lart si aktor  
fillestar mendjelehtë;  
babanë, babanë!...

Babai qesh, qesh,  
nëna hesht, nëna bujare,  
indiferente.

Por fëmija papritur,  
papritur,  
fëmija që kishte deklamuar si aktor,  
që kishte bërë një hile me arsyen e një të  
rrituri,  
papritur brofi me zemërim  
dhe qau si fëmijë!



## KAFSHË E URTË PUNE

Të gjithë janë treguar të padrejtë me ty,  
kafshë pune e lodhur, e urtë, që nuk të  
përket asnjë mëkat,  
gërdallë e pafajshme që dremit gojëkyçur  
përpara grazhdit të varfër  
me ca kashtë të paregjur dhe gjemba të  
tharë.

Të gjithë fabulistët, jo vetëm mediokrit, por  
edhe më të mënçurit,  
Ezopi e La Fonteni të përçmuan pa mëshirë,  
veshgjat i gjorë,  
ty kafsha më e urtë dhe më e bindur në  
botë.

(Edhe ata, natyrisht, ëndërruan kuajt.)

Padrejtësia e tiranëve rëndon mbi

gjithçka,  
por padrejtësia e të mençurve rëndon mbi  
të urtët,  
mbi qeniet e padjallëzuara që s'bëjnë asnjë  
mëkat!

Pikërisht këtë do të ketë vajtuar i verbri,

Sanço Panço  
kur ti, miku i tij i dashur me emrin murro,  
papritmas humbe (ç'katastrofë për Sançon!)

në tymin e dendur që ngrihej në horizont,  
në betejat e luftëtarit të madh Don Kishot.

## PAS NJË ÇASTI ZEMËRIMI

Në çdo skaj të sallës, plot ankth  
të kërkonin ty, vallëzuese gazmore,  
dhe të ndiqnin kudo pas vallëzuesve të  
ku ti e zemëruar largoheshe, largoheshe,  
Atëherë ti, balerinë kokëfortë,  
me shpejtësi të çuditshme u rrotullove  
dhe në një kozmos trillesh humbe krejt,  
siç ndodh me planete në galaktika të  
larg nga toka me mijëra vjet.  
Por unë vij drejt teje me një shpejtësi  
dhe prap shikimi im gjithë ankth ty të  
dhe ti e mundur,  
nga tjetri skaj i sallës,  
drejt meje e qeshur vjen.

## LODRAT E FËMIJËVE

Sa herë i keni këshilluar fëmijët ju,  
burra,  
që lodrat e tyre të jenë të matura,  
e sidomos keni shfryrë me mërzi kundër  
tyre,  
kur zërat fëmijënorë janë ngjitur deri lart,  
në sallën solemne ku ju bëni mbledhje,  
në zyrën e qetë ku shkruani raporte,  
e deri në dhomën gjysmë të errët  
të gjumit çlodhës të drekës.  
Po këta të «prapë», të përkëdhelur,  
«rrugaçë»,  
siç i keni quajtur shpesh me mërzi,  
përsëri kanë «ngrirë», kanë «shkrirë»,  
janë bërë erë  
si personazhet e tragjedive të epokës  
antike,  
kanë ecur symbyllur (sipas rregullit të  
lojës);  
fituesit me zëra të potershëm, të bujshëm  
dhe të mundurit me zëra të trishtë.  
Në këtë çast ju, burra, jeni zemëruar më  
keq,

keni thënë se këto lodra s'kanë masë, s'kanë  
dhe ndonjëri prej jush e ka ndëshkuar  
që tek qoshja e shtëpisë të rrijë me një  
Po ju që shkruani referate, pamflete,  
që kërkoni nga fëmijët të jenë veç të  
s'keni vënë re kur luajnë fëmijët,  
kur ngrijnë, kur shkrijnë, kur ecin  
si këto ata ia besojnë njëri-tjetrit,  
pa zor aspak, pa sherre burrash,  
dhe sidomos pa pasur garant një arbitër?

## LOJA E SHAHUT

Të parët vërsulen ushtarët  
(sigurisht, ata vlejné më pak).  
Figurat struken pas tyre  
dhe mbretërit fshihen pas rokadës.

Falet një ushtar, pastaj dy;  
(diku në botë falen mijëra).  
Është thënë që të vdesin të parët,  
të dytat gjithmonë figurat.

Po ja, një ushtar bën një hap  
në kolonën krejt i lirë, —  
befas mbretërit lëvizin me tmerr  
në katrorët e bardhë dhe të zinj.

Ky është çasti më fatlum për ushtarin,  
që vrapon të marrë titullin «Figurë»,  
të mos vdesë në një radhë me të parët  
në betejën me tym e me zhurmë.

Por është çasti më tragjik për mbretërit,  
(për fituesin po aq sa për të mundurin)  
që gjithçka e marrin të parët  
dhe veç vdekjen e marrin të fundit.





SOT TI ISHE ÇUDITËRISHT  
E MIRËSJELLSHME

Asnjëherë s'ke qenë kaq e mirësjellshme,  
kaq e qetë, kaq e plogët, kaq e kujdesshme...  
Dhe dukesh si njeriu që u shërue nga një

plagë,  
nga një plagë që i ka dhëmbur gjatë, gjatë.  
... Po është një plagë dashuria, një plagë,  
një plagë që lumturisht dhemb ditë e netë,  
që vetëm shërimi ndofta i bën keq.

Po sot ti ishe çuditërisht e mirësjellshme  
dhe qetë më the të dua, dhe qetë më  
buzëqeshe...

Të gjitha diplomacitë përshpërisin këtë  
fjalë,

kur gënjejnë nga pak.

Dhe trupat më të errët dinë të bëjnë dritë,  
dinë të fshehin errësirën.

Asnjëherë s'ke qenë kaq e mirësjellshme,  
asnjëherë s'më ke trishtuar kaq shumë,  
asnjëherë.

ATYRE QË PAGUAJNË TAVOLINËN  
DITËN E DIEL.

Ata që paguajnë tavolinën ditën e diel  
Vijnë nga periferitë,  
dhe nuk janë të njohur ata që paguajnë  
ditën e diel.

Ata veshin shpesh kostume të gatshme  
pa pretendime për të pasur ngjyrën e  
stinës,  
ata nuk janë shik,

s'e kanë kollarisur jakën  
e këmishës,  
dhe shpesh janë personazhe pozitive të  
reportazheve  
në gazetat e ditës.

I shikoj me trishtim ata që paguajnë sipas  
një riti të lashtë,  
ata njerëz bujarë, ata njerëz të mirë,  
që në çastin kur paguajnë —

krejt me të padrejtë,  
nuk shikojnë tinëz mos dikush i përgjon,  
nuk dyshojnë aspak te llogaria e kamerierit  
dhe reston pa numëruar e futin në xhep.

ËSHTË NJË LUFTË E PËRJETSHME  
MIDIS MEJE DHË TEJE...

Është një luftë midis meje dhe teje,  
është një luftë e gjatë,  
një luftë e përvjetshme.  
Është një luftë brenda meje:  
arsyeja dhe zemra  
me njëra-tjetrën ndeshen...  
Çuditësh? Trembesh?  
Është një luftë minutash,  
një luftë sekondash,  
një luftë sendesh  
përderisa gjithçka me fytyrën tënde  
rreth meje endet...  
Është një luftë pa heronj,  
një luftë pa therorë,  
një luftë pa të mundur  
dhe pa triumfatorë,  
pa gjeneralë parade  
dhe pa ushtarë të plagosur...  
Është një luftë brengje  
brenda meje dhe teje,  
një luftë pa histori  
dhe pa sheshe beteje,  
pa tymra të frikshëm

po me pak mjegull të lehtë  
që shërben si tualet  
për fytyrën tënde...  
Është një luftë-dashuri  
midis meje dhe teje,  
një luftë që shëmbëllen  
me paqen e njerëzve.

## F J A L Ë T

Fjalët prej penës binin në letër  
pa resht, me nxitim njëra pas tjetrës,  
si shiu i gjatë në një natë vjeshte.  
Nxitova t'i ndalë me pika, me presje,  
me kllapa paranteze...

Por ata binin, binin papushim  
si mizëri ushtarësh të kohëve antike,  
kapërcenin me vrull hendeqet e presjeve,  
shkelnin mbi pikat, rrëzonin kllapat  
dhe pika çuditëse dhe pika pyetëse...

Binin në letër, fluturonin në ajër,  
putheshin, qeshnin me njëra-tjetrën  
si kukulla çamarroke në duar fëmijësh  
jashtë ligjeve të sintaksës përfaqësoheshin  
antonimet,  
si aktorët që luajtën Çezarin me Brutin,  
përçafonin njëri-tjetrin pas suksesit.  
Dhe befas mbushën hapësirën e dhomës  
e shkëlqenin butësisht secila me vete,  
si xixëllonjat e verës, si fishekzjarrë të  
festës. -

Ejani tani ju, gojëtarë të ëmbël,  
ju, profetë të së ardhmes, ju, mjeshtra të  
penës,  
ne jemi gati të luajmë të gjitha rolet  
dhe sidomos të luamë në rolin e së vërtetës.

NJË VAJZË ECËN KOKULUR BUZË  
DETIT

Moj vajzë që ecën kokulur buzë detit,  
kushedi çfarë brengje të mundon,  
ose ecën kokulur se është e pahijsme  
t'i shkosh detit të madh me kokën lart.  
Ja, ti ndale një çast pranë valëve,  
ti ndoshta çuditësh që deti i madh  
flet me zë kaq të ulët, kaq të ngadaltë  
se ndryshe ke menduar për zërat e

gjigantëve:

zëra që dëgjohen nga skaji në skaj,  
(xhuxhë që klithin dhe dëgjohen që larg).  
Po valët që vijnë njëra pas tjetrës  
kushedi ç'pëshpërisin si buzë fëmijnore  
dhe ti çuditësh, çuditësh, vajzë e vogël,  
si detit të madh i mjafton sakaq  
veç me ty të flasë,  
i mjafton brenga jote të trishtohet pak;  
krejt ndryshe nga zakoni i  
pseudotëmëdhenjve,  
që duan të gjunjëzojnë njerëzit  
me zërin e tyre të frikshëm, të lartë.

PROÇESVERBALI IMAGJINAR  
I NJË KAMARIERI

Asgjë e re nuk ndodhi në kafe,  
në orët e këtij mëngjesi me diell:  
Veç këtë paket DS të sapofilluar  
dhe këtë çakmak të blertë,  
i harroi ndofta prej hutimit,  
një muzikant i hollë, i sapomartuar,  
që ishte ulur në tryezën e fundit  
me shefin e strehimit.

## BABAI I ARTISTIT TË ARDHSHËM

Ai beson se djali i tij  
nesër do të jetë artist i madh.  
Djali i heshtur, indiferent,  
djali që buzëqesh rrallë e më rrallë.  
Dhe babai i madh i fëmijërisë,  
i krahasuar me mburrje me Mujin dhe  
Halilin,  
stepet prej tij, i penduar, me faj...  
Djali plot të «drejtë» e ngre zërin më lart;  
shfryn, revoltohet,  
klith,  
qan.

babai zvogëlohet,  
babai i thinjur që dikur ishte i madh.  
Babai përsëri e bën veten me faj, —  
Ç'respekt ka babai për artin e madh!



## DY GJIMNAZISTËT NË BULEVARD

Dy gjimnazistët e dashuruar befaz shëtitën  
në bulevard,  
të lirë, të qeshur, të etur,  
të shkujdesur,  
ecnin dhe loznin me njëri-tjetrin,  
bisedonin, këndonin, fishkëllenin...  
Luanin aktin e parë (të vetmin të gëzuar)  
të tragjedisë shekspiriane «Romeo dhe  
Xhuljeta».  
Të dy «kundravajtësit» triumfatorë,  
mendjelehtë,  
nxitonin, qeshnin, shkëlqenin nga gëzimi,  
si dy vargje poetikë me bukuri hyjnore,  
shkëlqejnë kur fitojnë të drejtë botimi.  
Ëndërrues, besnikë, të betuar,  
krenarë,  
Lëvdonin njëri-tjetrin si Ronsari me  
Kasandrën,  
me gëzimin e sigurtë të aktit të parë,  
ecnin me një hap aq delikat  
sa m'u desh të buzëqeshja në shenjë  
admirimi,  
mos t'u prishja ekuilibrin me shikimin tim  
të vrazhdë.

## GURËT E VENDLINDJES

Gurët e lashtë të vendlindjes sime,  
si karvanarë që u ka buzëqeshur fati,  
ndrijnë të rreshtuar njëri pas tjetrit.  
Të gjithë të bardhë në ngjyrën e agimit,  
rrinë gurët e vendlindës aty ku kanë rënë  
dhe rruga ndriçon prej tyre në mbrëmje  
se çdonjëri prej tyre mban mbi shpinë një  
hënë.

Unë eci mbi ta i sigurt, i qetë  
se e di që ata më çojnë në një botë  
pa mister.

## P E R M B A J T J A

Porta e pritjes së popullit .....	3
Dekorimi i punëtorëve të fushës .....	4
Mbretërimi i fëmijës në karrocën e dorës .....	5
Fusha .....	6
E qeshura e papritur e një vajze në rrugë .....	7
Në këtë mëngjes dimri .....	9
Simpatizanti i romanit «Don Kishoti i Mançes» .....	10
Kur mungoj ditë të tëra .....	11
Karriget e shtëpisë sime .....	12
E vetmja përsëritje që s'është monotone .....	13
I parakohshmi .....	15
I vogli dhe i madhi .....	17
Dy spektakle në bar «Blerimi» .....	18
Fqinja ime dikur vraponte me sandale .....	19
Harresa e fëmijëve .....	20
Rikthim në një moshë të hershme .....	21
Ti që ngurron të hysh në shtëpinë e fshatarit .....	22
E diel .....	24
Jashtë teme .....	25
Preludi i vajzës së rritur .....	26
Klounët .....	27
Alarm i fëmijëve në park .....	28
Si krijohet një gjëzë .....	30

Sot u zgjova në mëngjes papritur .....	31
Eskiz për fëmijë dhe për burra .....	33
Besoj vetëm një dashuri .....	34
Gjërat e përkohshme .....	35
Fëmija i zemëruar me burrat .....	36
Letra të bardha mbi tavolinë .....	38
Klubi në periferi të qytetit .....	40
Apalogjia e manekinëve prej druri .....	41
Besnikëri bashkëshortore .....	42
Zgjedhja e personazheve të fabulës .....	43
Mos u çudit .....	44
Një mësim nga lënda e mjeshtërisë së aktorit ...	45
Kafshë e urtë pune .....	47
Pas një çasti zemërimi .....	49
Lodrat e fëmijëve .....	50
Loja e shahut .....	52
E dashura e poetit .....	54
Sot ti ishe çuditërisht e mirësjellshme .....	55
Atyre që paguajnë tavolinënditën e diel ...	56
Është një luftë e përjetshme midis meje dhe teje .....	57
Fjalët .....	59
Një vajzë ecën kokukur buzë detit .....	60
Procesverbali imagjinar i një kamerieri .....	61
Babai i artistit të ardhshëm .....	62
Dy gjimnazistët në bulevard .....	63
Gurët e vendlindjes .....	64

Xhaferri, Bujar

Gjërat e përkohshme: Poezi /Bujar Xhaferri; Red.. I: Nelaj: — T.; Naim Frashëri, 1990, 68., 18 cm:

891.983-1

Xh 17

U dorëzua për shtyp Prill 1990  
Doli nga shtypi Gusht 1990

Tirazhi 2000 kopje    Formati 49x78/16    Stash. 2204-82

Shtypur në KOMBINATIN POLIGRAFIK  
Shtypshkronja e Re, Tiranë 1990